

VENDIM
Nr. 737, datë 13.12.2023

**PËR MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR REFORMËN NË ADMINISTRATËN
PUBLIKE 2023–2030**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023–2030, si dokument i politikave shtetërore, piketa hapëse të grupkapitullit të parë “Themeloret”, në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Departamenti i Administratës Publike dhe negociatori për Reformën në Administratën Publike merr masat për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të këtij udhërrëfyesi.

3. Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike dhe të gjitha institucionet që kanë në përgjegjësi masat e përfshira në udhërrëfyes për zbatimin e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËRRËFYESI PËR REFORMËN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE, 2023–2030

I. ZHVILLIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE

FUSHAT DHE NËNFUSHAT/ PARIME'T	KUADRI STRATEGJIK/ LEGJISLATIV/ INSTITUCIONAL	ZBATIMI I REFORMAVE DHE KAPACITETET INSTITUCIONALE	FUNKSIONIMI DHE PERFORMANCA E ADMINISTRATËS PUBLIKE
<i>Planifikimi i politikave dhe buxheti janë të harmonizuara; objektivat e politikave janë të mirë përcaktuara, të monitoruara dhe të vlerësuara. Financat publike planifikohen në mënyrë transparente dhe të qëndrueshme dhe mundësojnë realizimin e objektivave të politikave. Politikat publike zhvillohen përmes një procesi të hapur, të bazuar në prova dhe analiza solide, koherente dhe të mirë koordinuara në të gjithë qeverinë.</i> <i>a) Koordinimi dhe komunikimi i politikave të qeverisë</i> <i>b) Planifikimi dhe buxhetimi i integruar i politikave</i> <i>c) Përcaktimi, monitorimi dhe vlerësimi i objektivave të politikave</i> <i>d) Qeverisja për integrimin evropian</i>	- Korniza strategjike e Reformës së Administratës Publike (RAP) është e miratuar dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) dhe monitorohet në mënyrë efektive nga qeveria dhe palët e interesuara. Kjo kornizë strategjike përfshin Strategjinë e Reformës së Administratës Publike, Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike, Strategjinë për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, Strategjinë Antikorrupsion, Strategjinë e Agjendës Digjitale. <i>Afati viti 2024</i> - Strategjitë e reja sektoriale dhe ndërsektoriale janë në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) që shtrihen deri në vitin 2030. - Përgatitja e udhërrëfyesit për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara.	- Koordinimi i politikave dhe përafrimi me objektivat zhvillimore kombëtare dhe ndërkombëtare janë përmirësuar nëpërmjet riorganizimit dhe thjeshtimit të Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) dhe ekipeve tematike, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit efektiv ndërsektorial, planifikimin strategjik dhe shpërndarjen e duhur të burimeve. <i>Afati viti 2024</i> - Monitorimi dhe raportimi i politikave është përmirësuar përmes sistemit të ri informatik të planifikimit strategjik të integruar (IP SIS) duke përfshirë aktivitetet e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave. <i>Afati viti 2024</i>	- Ndërhyrjet e qeverisë në fushën e Reformës së Administratës Publike bazohen në dokumente strategjike të konsultuara me të gjitha palët e interesuara, me objektiva dhe tregues të qartë dhe të publikuar, për të siguruar monitorimin nga shoqëria civile. <i>Afati viti 2025</i>
	- Hartimi i Dokumentit të Politikave Prioritare trevjeçare (DPP) për të përfshirë strategji të ndryshme kombëtare, reforma ekonomike dhe plane të integritetit evropian, me qëllim sigurimin e shpërndarjes më efektive të burimeve dhe vendimmarrjeve strategjike, në përputhje të plotë me zhvillimet e shoqërisë dhe të dhënat e rezultuara nga censusi i fundit - <i>Afati viti 2024</i>		- Lista unike e projekteve me rëndësi kombëtare e inkomporuar në procesin e vendimmarrjes – e miratuar për herë të parë në vitin 2023, do të miratohet/ përditësohet në baza vjetore.
	- Harmonizimi ndërmjet programimit ligjor dhe proceseve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR/RIA) do të përmirësohet me synimin e promovimit të politikëbërjes më efektive dhe efektive - <i>Afati viti 2025</i> - Përgatitja e legjislacionit zbatues për të siguruar harmonizimin ndërmjet këtyre 2 proceseve - <i>Afati viti 2025</i> - Hartimi i udhëzimeve dhe procedurave për të siguruar që Vlerësimi i Ndikimit Rregullator të kryhet përpara se aktet ligjore/nënligjore të propozuara të përfshihen në agjendën legjislative - deri në vitin 2025.	- Monitorimi cilësor i përputhshmërisë së procedurave të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator dhe dhënia e komenteve/reagimeve për palët e interesuara nga Kryeministria. - Vlerësime të rregullta dhe raporte monitorimi të kryera dhe të përgatitura nga Kryeministria për të përmirësuar procesin e harmonizimit bazuar në reagime – raporte periodike (muajore, tremujore dhe vjetore).	- Udhëzime të qarta dhe gjithëpërfshirëse që përshkruajnë se si Vlerësimi i Ndikimit Rregullator dhe programimi ligjor ndërthuren dhe plotësojnë njëri-tjetrin. - Do të krijohet një bazë të dhënash solide në këtë fushë duke konsoliduar arritjet dhe duke përmirësuar ndjeshëm procesin e programimit ligjor. Kjo përfshin zhvillimin dhe zbatimin e rregulloreve efektive, me një qëllim të qartë për të reduktuar burokracinë administrative dhe kostot.
		- Sigurimi i burimeve dhe kapaciteteve adekuate në Kryeministri dhe institucionet përkatëse për avancimin e mëtejshëm të cilësisë së Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, programimit ligjor dhe procedurave të konsultimeve publike dhe monitorimit cilësor të këtyre proceseve.	- Kurrikulat dhe modulet e trajnimit të përfunduara. Rritja e numrit të nëpunësve publikë të trajnuar për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator, konsultimin publik dhe proceset e programimit ligjor. - Krijimi i partneriteteve me institucione të tjera.

		- Duke filluar nga viti 2025: (i) cilësia dhe numri i trajnimeve të ofruara për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator për zyrtarët publikë do të rritet duke zhvilluar dhe zbatuar një program trajnimi gjithëpërfshirës mbi Vlerësimin e Ndikimit Rregullator, mbi konsultimet publike dhe parimet dhe metodat e programimit ligjor dhe harmonizimin ndërmjet këtyre proceseve; (ii) Identifikimi i grupeve të synuara të nëpunësve civilë që do të trajnohen; (iii) Rritja e bashkëpunimit me institucione dhe organizata të tjera (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike/ASPA, BE, Shkolla Rajonale e Administratës Publike/RESPA, SIGMA, etj.) për të shfrytëzuar burimet dhe ekspertizën.	
	- Deri në vitin 2025, harmonizimi i proceseve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator dhe të konsultimit publik do të përmirësohet, duke siguruar që komentet/reagimet e marra nga palët e interesuara të integrohen siç duhet në raportet e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator dhe të merren parasysh në vendimmarrjen rregullatore. Udhëzimet do të përmirësohen për të integruar procesin e konsultimit publik në procesin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator.	- Krijimi i mekanizmave për komunikim dhe koordinim ndërmjet rrjetit të koordinatorëve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator dhe rrjetit të koordinatorëve të konsultimit publik në të gjitha institucionet publike për integrimin e komenteve/reagimeve të palëve të interesuara në raportet e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator - deri në vitin 2025.	- Koordinim i përmirësuar ndërmjet anëtarëve të rrjetit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator dhe Konsultimit Publik në ministritë e linjës. - Përqindje e rritur e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator që integrojnë informacionin nga procesi i konsultimit publik. - Raporte të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator të përmirësuara.
	- Rritja e cilësisë së raporteve të konsultimit publik dhe plotësimi i strukturave përgjegjëse me staf të përgatitur dhe të mirëtrajnuar. Deri në vitin 2030, procesi i konsultimit publik do të zgjerohet në legjislacionin dytësor me karakter normativ dhe në fushat me interes të lartë publik si mjedisi, ekonomia dhe çështjet sociale. - Ndryshimet në ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe në legjislacionin dytësor mbi konsultimin publik. <i>Afati dhjetor 2029</i>	- Nëpunësit civilë të aftësuar në zbatimin e procesit të konsultimit publik për legjislacionin dytësor me karakter normativ dhe në fushat me interes të lartë publik si mjedisi, ekonomia dhe çështjet sociale. deri në dhjetor 2029. - Forcimi i kulturës së pjesëmarrjes të publikut dhe i aktorëve të tjerë, dhe rritja e llogaridhënies së institucioneve në proceset e vendimmarrjes përmes konsultimit publik. - Monitorim dhe vlerësim i efektivitetit të procesit të shtrirjes së konsultimit publik për legjislacionin dytësor me karakter normativ dhe në fushat me interes të lartë publik si mjedisi, ekonomia dhe çështjet sociale, duke filluar nga viti 2030.	- Do të zhvillohet një proces efektiv i konsultimit publik për legjislacionin dhe politikat me interes të lartë publik, duke arritur pjesëmarrje të gjerë nga të gjithë aktorët përkatës dhe duke siguruar nivele të larta të transparencës, gjithëpërfshirjes dhe reagimit. - Administrata publike në nivel qendror dhe pushteti vendor kryejnë procesin e konsultimit publik bazuar në standardet më të larta. - Raporte monitorimi të orientuara drejt përmbajtjes dhe cilësisë, të përgatitura periodikisht nga njësia përgjegjëse e mbikëqyrjes, që shërbejnë si një mjet për vlerësimin e nevojave për trajnim për nëpunësit civilë të përfshirë në këtë proces.
	- Rritja e cilësisë së raporteve të vlerësimit të ndikimit rregullator dhe plotësimi i strukturave përgjegjëse me staf të përgatitur dhe të mirëtrajnuar. Deri në vitin 2030 procesi i vlerësimit të ndikimit rregullator do të zgjerohet në legjislacionin dytësor me karakter normativ dhe në fushat me interes të lartë publik si mjedisi, ekonomia dhe çështjet sociale. - Hartimi i kritereve, bazuar në praktikat më të mira, për përzgjedhjen e legjislacionit dytësor që i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit rregullator - dhjetor	- Hartimi i udhëzimeve dhe metodologjisë për kryerjen e vlerësimit të ndikimit rregullator për legjislacionin dytësor me karakter normativ dhe në fushat me interes të lartë publik si mjedisi, ekonomia dhe çështjet sociale. <i>Afati dhjetor 2029</i> - Ofrimi i trajnimeve për nëpunësit publikë në lidhje me procesin e vlerësimit të ndikimit rregullator për legjislacionin dytësor me karakter normativ dhe në	- Lista e kritereve e finalizuar dhe e miratuar zyrtarisht. - Udhëzime të hartuara dhe integruara në metodologjinë ekzistuese të vlerësimit të ndikimit rregullator dhe nëpunës publikë të trajnuar për procesin e vlerësimit të ndikimit rregullator për legjislacionin dytësor me karakter normativ dhe në fushat me interes të lartë publik si mjedisi, ekonomia dhe çështjet sociale. - Procesi i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator i

	2028 dhe ndryshimi i legjislacionit përkatës për të përfshirë kriteret e reja deri në dhjetor 2029.	fushat me interes të lartë publik si mjedisi, ekonomia dhe çështjet sociale. <i>Afati qershor 2030</i> - Monitorim dhe vlerësim i efektivitetit të procesit të shtrirjes së vlerësimit të ndikimit rregullator për legjislacionin dytësor me karakter normativ dhe në fushat me interes të lartë publik si mjedisi, ekonomia dhe çështjet sociale – në vazhdim nga viti 2030.	zbatuar në legjislacionin dytësor me karakter normativ dhe në fushat me interes të lartë publik si mjedisi, ekonomia dhe çështjet sociale të përzgjedhur sipas kriterëve dhe metodologjisë së përcaktuar deri në vitin 2030. - Raporte monitorimi të orientuara drejt përmbajtjes dhe cilësisë, të përgatitura periodikisht nga njësia përgjegjëse e mbikëqyrjes, që shërbejnë si një mjet për vlerësimin e nevojave për trajnim për nëpunësit civilë të përfshirë në këtë proces.
	- Deri në vitin 2030 do të nisë përdorimi i vlerësimit të ndikimit rregullator ex-post për të siguruar që kuadri ligjor të monitorohet dhe përmirësohet vazhdimisht për një efektivitet sa më të lartë.	- Hartimi i udhëzimeve dhe metodologjisë për kryerjen e vlerësimit të ndikimit rregullator ex-post mbi legjislacionin ekzistues. <i>Afati tetor 2030</i> - Hartimi i një kurrikule trajnimi gjithëpërfshirëse për nëpunësit publikë në lidhje me vlerësimin e ndikimit rregullator ex-post dhe zhvillimi i trajnimeve dhe seminareve përkatëse. <i>Afati nëntor 2030</i> - Vlerësimi i rezultateve të vlerësimit të ndikimit rregullator ex-post mbi rezultatet e akteve rregullatore, duke filluar nga dhjetori i vitit 2030.	- Udhëzime të hartuara dhe integruara në metodologjinë ekzistuese të vlerësimit të ndikimit rregullator. - Kurrikul trajnimi për vlerësimin e ndikimit rregullator ex-post e përfunduar dhe workshope, seminare e trajnime të zhvilluara për nëpunësit publikë. - Raporte monitorimi të orientuara drejt përmbajtjes dhe cilësisë, të përgatitura periodikisht nga njësia përgjegjëse e mbikëqyrjes, që shërbejnë si një mjet për vlerësimin e nevojave për trajnim për nëpunësit civilë të përfshirë në këtë proces.
	- Hartimi i një Plani të ri Kombëtar gjithëpërfshirës për Integrimin Evropian bazuar në Programin Kombëtar të Aderimit në Bashkimin Evropian, duke synuar të gjithë acquis-në e zbatueshme dhe objektivat e evidentuara gjatë takimeve bilaterale të procesit screening, brenda planit afatgjatë 2030. - Kuadri rregullator për përgatitjen e versionit kombëtar të acquis së BE-së funksional brenda vitit 2025. - Rishikimi i kuadrit ligjor për organizimin institucional të strukturave kombëtare përgjegjëse për integrimin në BE, në vitin 2024, me qëllim adresimin e sfidave dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.	- Plan i ri Kombëtar për Integrimin Evropian bazuar në qasjen e PKABE për periudhën 2024-2030. - Forcimi i rolit të Sekretariatit të BE-së, në Kryeministri, që vepron si Qendra e Qeverisjes përgjegjëse për monitorimin e integritetit në BE/kontrollin e cilësisë së kapaciteteve sipas standardeve të BE-së në përputhje me acquis, brenda vitit 2024. - Plani Menaxherial i Integritetit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative, i pilotuar deri në vitin 2024 dhe i hartuar për 33 kapituj deri në vitin 2025, për të adresuar sfidat e identifikuar në rekomandimet specifike të Komisionit Evropian, në mënyrë që kapacitetet administrative dhe institucionale të zbatohen në mënyrë efektive acquis-në dhe të kenë aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. - Planet e ngritjes së kapaciteteve bazuar në nevojat për trajnim të kapaciteteve për të gjitha strukturat përkatëse, duke përfshirë strukturat sektoriale dhe horizontale, me qëllim adresimin e sfidave në kuadër të harmonizimit dhe zbatimit të acquis së BE-së – duke filluar nga viti 2024.	- EU Toolbox zbatohet në praktikë për të gjithë kapitujt e acquis-së dhe institucionet (qendrore/rajonale/vendore) performojnë në mënyrë më eficiente dhe efektive duke rritur kapacitetet e nëpunësve përmes një qasjeje menaxhuese në të gjitha nivelet e integritetit evropian. <i>Afati viti 2030</i> - Arritja e një niveli të mirë të harmonizimit me acquis-n e BE-së deri në vitin 2028. - Strukturat negociuese kanë kapacitetet e duhura për të zhvilluar negociatat në kuadër të anëtarësimit dhe për të zbatuar angazhimet e marra përsipër. - Platforma e Partneritetit për Integrimin në BE dhe rrjetet janë në funksion dhe performojnë mirë për të gjithë kapitujt e acquis, duke filluar nga viti 2024. - Raporti Kombëtar i Vlerësimit të Indeksit të Kapaciteteve të Integritetit Evropian i hartuar deri në vitin 2024, bazuar në standardet e BE-së, për t'iu përgjigjur me një qasje të përshtatur specifikisht për administratën publike, me qëllim përmbushjen e kriterëve për anëtarësimin në BE. <i>Afati 2024 - 2029</i> - Hartimi i Planit të Kapaciteteve të Integritetit Evropian dhe programit të monitorimit.

		- Parlamenti përdor të gjithë mekanizmat për të mbikëqyrur në mënyrë efektive punën e qeverisë – Në vazhdim - Zhvillimi i takimeve të përbashkëta periodike mes Parlamentit, Qeverisë dhe institucioneve të pavarura për të diskutuar dhe mbikëqyrur zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga institucionet e pavarura - në vazhdim	- Një rol proaktiv dhe i përmirësuar për Parlamentin për mbikëqyrjen e qeverisë dhe për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura - Në vazhdim
--	--	---	---

II. SHËRBIMI CIVIL DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

FUSHAT DHE NËNFUSHAT/ PARIMET	KUADRI STRATEGJIK/ LEGJISLATIV/ INSTITUCIONAL	ZBATIMI I REFORMAVE DHE KAPACITETET INSTITUCIONALE	FUNKSIONIMI DHE PERFORMANCA E ADMINISTRATËS PUBLIKE
<i>Sërbimi civil është një punëdhënësi tërheqës. Nëpunësit civilë veprojnë me profesionalizëm, integritet dhe neutralitet. Ata rekrutohen dhe promovohen në bazë të meritave dhe të mundësive të barabarta dhe kanë kompetencat e duhura për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive.</i> <i>a. Shërbimi publik si një punëdhënësi tërheqës</i> <i>b. Profesionalizmi dhe integriteti në shërbimin publik</i> <i>c. Burimet njerëzore parë në kontekstin strategjik fokusuar në risi/ inovacion</i>	- Politika e pagave e miratuar duke ndryshuar strukturën e pagave në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”. <i>Afati viti 2024</i> - Miratimi i metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës pas ndryshimeve ligjore. <i>Afati viti 2025</i>	- Ndërhyrjet në paga të zbatuara për të garantuar atraktivitetin /konkurueshmërinë e administratës publike – dy faza: i. Rritja e pagave për nëpunësit civilë në institucionet e administratës shtetërore dhe në institucionet e pavarura; në sektorin e shëndetësisë; ndërhyrje të pjesshme në strukturën e pagave – rritje e shtesës për vjetërsi në punë për të shpërblyer përvojën në administratën publike – përfunduar në 2023 ii. Rregullimet përfundimtare të komponentëve të pagës për nëpunësit civilë; rritja e pagave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, forcat e armatosura, policinë, sektorin e arsimit - <i>dhjetor 2025</i> - Zbatimi i metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil - <i>Afati viti 2025</i> - Procedurat e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore bazohen edhe në sistemet e gjenerimit të të dhënave të sakta dhe në përdorimin e plotë të teknologjisë për thjeshtimin e proceseve të punës në fushën e MBNJ - <i>Afati viti 2028</i>	- Administrata publike mbetet atraktive në tregun e punës. Rritje e numrit të aplikimeve për pozicionet vakante. - Raporti i pagave është rregulluar për pozicionet drejtuese për të përballuar largimet nga pozicionet e niveleve të larta drejtuese. - Shtesa për vjetërsi në punë është rritur për të shpërblyer përvojën për pozicionet në administratën publike. - Paga mesatare mujore në administratën publike e rritur në 900 euro deri në vitin 2024, nga 530 euro aktualisht. - Rritje e pagave për nëpunësit civilë në vitin 2023: i. pozicionet e kategorisë ekzekutive nga 19-41%; ii. pozicionet në nivelin e ulët drejtues 28-34%; iii. pozicionet në nivelin e mesëm dhe të lartë drejtues 25-35%. - Rritje e pagave për nëpunësit civilë në vitin 2025 për pozicionet e kategorisë ekzekutive me 11-16% krahasuar me vitin 2023. - Sistemet digjitale që mbështesin menaxhimin dhe shkëmbimin e informacionit në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore janë plotësisht funksionale dhe lejojnë automatizimin e listës së pagave dhe zbatimin e praktikave të mira dhe forcimin e komunikimit ndërmjet institucioneve të administratës publike, brenda vitit 2028.
	- Procedurat e rekrutimit për trupën e nivelit të lartë drejtues mirëpërcaktohen me ndryshimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, duke respektuar parimin e rekrutimit bazuar	- Zbatimi i programit të dedikuar të trajnimit për trupën e nivelit të lartë drejtues nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), fokusuar në aftësitë drejtuese.	- Trupa e nivelit të lartë drejtues rekrutohet dhe aftësohet duke respektuar parimet e përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil. <i>Afati viti 2025</i>

	në merita; përmirësimi i zbatimit të vendimeve të gjykatave në rastet e pushimeve nga puna; thjeshtimi i procedurave për vlerësimin e performancës për të rritur objektivitetin - <i>Afati viti 2024</i> - Rregullime në aktet zbatuese për procedurat e rekrutimit për kategoritë e tjera të nëpunësve civilë - <i>Afati viti 2024</i>	<i>Afati viti 2024</i> - Zbatimi i procedurave të rekrutimit bazuar në merita, duke përmirësuar cilësinë e testimit/vlerësimit të kandidatëve. Përshtatje e vazhdueshme e përshkrimeve të punës, për të rritur kur është e mundur numrin e procedurave të rekrutimit në grup.	- Rekrutimi në institucionet e administratës publike bazohet në konkurs të hapur, në parimin e meritës dhe siguron përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë.
	- Udhëzimet dhe rregulloret për çështjet e etikës dhe integritetit të rishikuara dhe miratuara deri në fund të vitit 2024. - Kuadri i etikës dhe integritetit i përditësuar vazhdimisht. - Manuali praktik për njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore për të promovuar zbatimin uniform dhe efikas të legjislacionit për integritetin, i përgatitur në bashkëpunim me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave - <i>Afati dhjetor 2024</i>	- Zhvillimi i një programi trajnimi gjithëpërfshirës që trajton çështjet kryesore të etikës dhe integritetit në administratën publike; kapacitetet e Departamentit të Administratës Publike të përmirësuara për të vepruar si organ qendror ndërgjegjësues - <i>Afati viti 2024</i> - Vendorsja e këshilltarëve për integritetin dhe etikën në të gjitha organet publike dhe marrja e masave që ata të kenë aftësitë, burimet dhe mbështetjen e nevojshme për të kryer rolet e tyre në mënyrë efektive - <i>Afati viti 2025</i>	- Nëpunësit publikë janë të aftësuar për çështjet e etikës dhe integritetit. Këshilltarët e integritetit dhe etikës janë plotësisht funksionalë në të gjitha institucionet publike. <i>Afati viti 2025</i> - Roli i Departamentit të Administratës Publike, si organ qendror për ndërgjegjësimin, i njohur plotësisht nga institucionet. <i>Afati viti 2025</i>
		- Vlerësimi në mënyrë të vazhdueshme i “hendekut” të aftësive të nëpunësve publikë dhe planifikimi i ndërhyrjeve të veçanta për të tërhequr nëpunës civilë të kualifikuar ose potencialë, veçanërisht në lidhje me përgatitjet për procesin e anëtarësimit në BE dhe zotërimin e gjuhëve të huaja. - Programe trajnimi efikase për mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve të nëpunësve publikë, bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim, të ofruara nga ASPA. - Ngritja e sistemit të cilësisë në fushën e zhvillimit profesional në administratën publike, përmes aplikimit të plotë të mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. <i>Afati viti 2025</i>	- Vlerësimi i Nevojave për Trajnim i kryer për të vlerësuar “hendekun” e aftësive digjitale. <i>Afati viti 2024</i> - Kurrikulat e trajnimit të përmirësuara, duke përfshirë edhe trajnime për aftësitë digjitale për nëpunësit e administratës publike në nivel qendror dhe vendor. <i>Afati viti 2025</i> - Programe të posaçme të krijuara për të tërhequr nëpunës civilë të kualifikuar dhe potencialë, të hartuara dhe zbatuara. <i>Afati në dy faza dhjetor 2025 dhe dhjetor 2027</i>

III. ORGANIZIMI, LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA

FUSHAT DHE NËNFUSHAT/ PARIMET	KUADRI STRATEGJIK/ LEGJISLATIV/ INSTITUCIONAL	ZBATIMI I REFORMAVE DHE KAPACITETET INSTITUCIONALE	FUNKSIONIMI DHE PERFORMANCA E ADMINISTRATËS PUBLIKE
<i>Administrata publike është e organizuar në</i>	- Amendimi i ligjit nr. 90/2012 “Për	- Një grup i caktuar institucionesh do të	- Korniza e llogaridhënies për institucionet e

<i>mënyrë efikase dhe efektive në të gjitha nivelet e qeverisjes. Organet e administratës publike zbatojnë mekanizma të përcaktuar qartë të llogaridhënies së brendshme dhe të jashtme, janë të hapura dhe transparente dhe mbikëqyrjen nga organe të fuqizuara për mbikëqyrjen dhe që mbrojnë të drejtat e qytetarëve dhe interesin publik.</i> <i>a. Organizim shtetëror funksional në të gjitha nivelet e qeverisjes</i> <i>b. Transparencë</i> <i>c. Mekanizma të llogaridhënies së brendshme dhe të jashtme</i> <i>d. Cilësia e sistemit të integritetit të sektorit publik</i>	organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” deri në dhjetor 2024, si dhe hartimi i legjislacionit dytësor deri në qershor 2025, me qëllim: (i) krijimin e kuadrit efektiv të llogaridhënies për institucionet e varësisë dhe (ii) mirëpërcaktimin e tipologjisë së institucioneve të varësisë.	mbështeten për të caktuar objektiva të mbështetura në rezultate dhe Indikatorët Kryesorë të Performancës, nëpërmjet të cilëve raportojnë periodikisht tek institucioni mbikëqyrës për rezultatet e arritura – në dy faza: i. një grup i përbërë nga 5 ministri dhe institucionet e tyre të varësisë mbështeten për procesin; si dhe monitorohen dhe vlerësohen rezultatet (<i>dhjetor 2024</i>) ii. praktika e shtrirë në të gjitha ministritë dhe institucionet e varësisë. Raporti i vlerësimit i hartuar në <i>dhjetor 2025</i>.	varësisë është e përmirësuar dhe ministritë ushtrojnë mbikëqyrje efikase ndaj tyre. <i>Afati viti 2025</i> - Krijimi i institucioneve të reja bëhet mbështetur në kritere të qarta lidhur me tipologjinë dhe legjislacionin e aplikueshëm. <i>Afati viti 2025</i>
	- I gjithë legjislacioni sektorial është në përputhje dhe i harmonizuar me Kodin e Procedurave Administrative. <i>Afati dhjetor 2025</i>	- Lista e akteve që duhet të harmonizohen me Kodin e Procedurave Administrative e përcaktuar deri në fund të vitit 2023.	- 65 akte ligjore të harmonizuara me Kodin e Procedurave Administrative deri në dhjetor 2025 për të përfunduar procesin e harmonizimit dhe publiku përfiton nga legjislacioni më modern në këtë fushë.
		- Rritja e llogaridhënies së institucioneve qendrore dhe atyre vendore në bashkëqeverisjen me qytetarët nëpërmjet mekanizmave të shumëfishtë, veçanërisht nga zbatimi i plotë i ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”. <i>Afati dhjetor 2025</i>	- Numri i ankesave të zgjidhura është rritur deri në dhjetor 2025; së bashku me masat korriguese të marra reflektojnë rritjen e performancës së nëpunësve dhe institucioneve. <i>Afati dhjetor 2025</i> - Të njëjtat standarde për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve që zbatohen nga institucionet e qeverisjes qendrore përdoren dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe do të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e ligjit 107/2021. <i>Afati dhjetor 2025</i>
	- Miratimi i legjislacionit dytësor për ligjin për të drejtën e informimit dhe për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, ligje këto të hyra në fuqi në 2023. <i>Afati qershor 2024</i>	- Procedurat e brendshme për aksesin në informacion dhe të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik miratohen nga institucionet kryesore deri në dhjetor 2024. <i>Afati dhjetor 2024</i> - Forcimi i kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit dhe të institucioneve të administratës publike për transparencën dhe menaxhimin e hapur të të dhënave, përmes	- Institucionet e administratës publike janë transparente dhe ofrojnë të gjithë informacionin e kërkuar nga publiku bazuar në ligjin për të drejtën e informimit dhe zbatojnë legjislacionin për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik. <i>Afati viti 2025</i> - Të gjithë koordinatorët për të drejtën e informimit kanë ndjekur trajnimin e certifikuar, të zhvilluar nga ASPA dhe Komisioneri për të

		trajnimeve të certifikuara të ofruara nga ASPA. <i>Afati dhjetor 2025</i>	Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbi të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit publik dhe të dhënat e hapura. - Trupa e nivelit të lartë drejtues ka ndjekur trajnimin e certifikuar, të zhvilluar nga ASPA dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbi të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit publik dhe të dhënat e hapura. - Rritja e numrit të përgjigjeve të dhëna nga autoritetet publike ndaj kërkesave për akses në informacionin publik.
--	--	---	--

IV. OFRIMI I SHËRBIMEVE

FUSHAT DHE NËNFUSHAT/ PARIMET	KUADRI STRATEGJIK/ LEGJISLATIV / INSTITUCIONAL	ZBATIMI I REFORMAVE DHE KAPACITETET INSTITUCIONALE	FUNKSIONIMI DHE PERFORMANCA E ADMINISTRATËS PUBLIKE
<i>Administrata publike vendos qytetarin në qendër dhe ofron shërbime me cilësi të lartë dhe lehtësisht të aksesueshme online dhe offline për të gjithë qytetarët dhe bizneset</i> - Fokusi te përdoruesit - Rritja dhe cilësia e shërbimeve - E-qeverisja e përafruar me standardet evropiane	- Rishikimi i Kornizës Kombëtare të Ndërveprueshmërisë, i përafruar me Kornizën e re Evropiane të Ndërveprueshmërisë – realizuar në 2023. - Për të siguruar rritjen e kualitetit të shërbimeve elektronike, portali e-Albania do të rindërtohet, bazuar në Aksesueshmërinë dhe Përvojën e Përdoruesit (UX), që do të përfshijë funksionalitetet e reja: (i) të inteligjencës së biznesit; (ii) marrjes së reagimeve të qytetarëve; dhe (iii) modeleve të ngjarjeve jetësore (life events model). <i>Afati dhjetor 2027</i>	- Forcimi i GovTech: Menaxhimi i gjithë të dhënave qeveritare. <i>Afati viti 2027</i> - Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve të ofruara për publikun në format elektronik, duke rishikuar dhe thjeshtuar proceset e biznesit dhe përdorimin e gjerë të vulës elektronike nga institucionet publike. <i>Afati në dy fazat: dhjetor 2024 dhe dhjetor 2026</i> - Përmirësimi i e-Services Backbone për të përmirësuar Portalin e Qeverisë (GG), që do të mundësojë shkëmbim më të mirë të të dhënave ndërmjet institucioneve të sektorit publik, në mënyrë që të ofrohen shërbime më të shpejta, më të dedikuara dhe, sipas rastit, më të personalizuar. <i>Afati viti 2026</i>	- Korniza Kombëtare e Ndërveprueshmërisë është në përputhje me aktin e ri <i>‘European Interoperability Framework’</i> dhe do të rishikohet për të qenë në përputhje me aktin e <i>‘Interoperable Europe’</i> (pas miratimit). - Shërbimet i ofrohen publikut në format elektronik, me kërkesa minimale për dokumente, pa vonesa, me kosto sa më të ulët dhe të gjithë publikut, pa asnjë pengesë. <i>Afati viti 2026</i> - Do të shkurtrohet koha mesatare që merr ofrimi i disa shërbimeve online të lidhura me gjashtë ngjarje jetësore prioritare (Life events). <i>Afati dhjetor 2026</i>
		- Miratimi i standardeve të përditësuara të shërbimit digjital për të përcaktuar dimensionet për shërbimet digjitale me cilësi të lartë, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të tyre. <i>Afati dhjetor 2027</i> - Rritja e monitorimit në kohë reale të	- Cilësia matet në përputhje me “Standardet e përditësuara të Shërbimit Digjital”, për shërbime digjitale me cilësi të lartë.

		efikasitetit të shërbimeve publike online dhe offline. <i>Afati dhjetor 2024</i>	
	- Përafrimi i direktivës (BE) 2016/2102 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 26 tetor 2016, mbi aksesin në faqet e internetit dhe aplikacionet mobile të institucioneve të sektorit publik. <i>Afati dhjetor 2024</i> - Përmirësimi i aksesit në shërbimet digjitale nga grupet e përzgjedhura të synuara - (i) popullsia në përgjithësi; (ii) grupet në nevojë (që përfshin një pjesë të madhe të popullsisë rome); (iii) të moshuarit (mbi moshën 65 vjeç); (iv) personat me aftësi të kufizuara; (v) përdoruesit e huaj; (vi) personat pa aftësi digjitale ose pa akses në pajisje digjitale. <i>Afati dhjetor 2027</i>	- Përmirësimi i portalit e-Albania për të qenë në përputhje me udhëzimet për aksesueshmërinë e përmbajtjes së uebit (WCAG 2.1). <i>Afati dhjetor 2027</i> - Ndërhyrjet për të rritur aksesueshmërinë: i. Qendra e re e kontaktit <i>Omnichannel</i> plotësisht funksionale, e bazuar në përvojën globale më të fundit, duke përshtatur një qasje të përqendruar të përdoruesit në ofrimin e asistencës për përdoruesit e shërbimit, duke ofruar kanale të ndryshme komunikimi, si portalin e-Albania, asistent virtual, thirrje zanore dhe asistencë direkte (nëpërmjet InfoPoints në Qendrat Shumëfunksionale të Inovacionit Rinor). <i>Afati dhjetor 2025</i> ii. Qendrat shumëfunksionale të Inovacionit Rinor të ngritura dhe plotësisht funksionale deri në dhjetor 2025; qendrat do të kenë kanalin për asistencë direkte, si pjesë e qendrës së kontaktit <i>Omnichannel</i>, duke shërbyer si një "<i>InfoPoint</i>" për të ofruar informacion, udhëzime dhe asistencë për përdoruesit e shërbimeve të cilët hasin probleme që lidhen me përdorimin e shërbimeve elektronike (si mundësia e fundit, kur përdoruesi ka përdorur çdo mundësi tjetër të qendrës së kontaktit), si dhe do të jetë në dispozicion të përdoruesve një pajisje vetë-shërbimi për të aplikuar për shërbime digjitale (kur përdoruesi nuk ka akses në një pajisje të tillë). Qendrat do të shërbejnë si një mjet për t'u ofruar të rinjve dhe grupeve të tjera në rajone të ndryshme, trajnime për të përmirësuar aftësitë e tyre digjitale, gjë që kontribuon në rezultatet e përgjithshme për përfshirjen digjitale dhe ngritjen e aftësive digjitale. iii. Asistenti Virtual Shqiptar (AVA) do të jetë plotësisht funksional, i automatizuar në tekst dhe zë, që do t'u përgjigjet pyetjeve të përdoruesve, duke shërbyer si asistencë <i>helpdesk</i> e Qendrës së Kontaktit të <i>Omnichannel</i>. Gjithashtu, ndihma do	- Përmirësimi i shërbimit ndaj klientit dhe aksesueshmërisë, modernizimi i arkitekturës së shërbimit ndaj klientit për ta bërë më të lehtë aksesin në shërbimet dhe asistencën digjitale, duke përfshirë grupet e synuara vulnerabël. <i>Afati dhjetor 2026</i>

		të jetë e përshtatur dhe për grupet vulnerabël. <i>Afati dhjetor 2027</i>	
--	--	--	--

V. MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE

FUSHAT DHE NËNFUSHAT/ PARIMET	KUADRI STRATEGJIK/LEGJISLATIV / INSTITUCIONAL	ZBATIMI I REFORMAVE DHE KAPACITETET INSTITUCIONALE	FUNKSIONIMI DHE PERFORMANCA E ADMINISTRATËS PUBLIKE
<i>Administrata publike planifikon dhe menaxhon financat publike për të siguruar që ato janë transparente dhe të qëndrueshme dhe për të lejuar arritjen e objektivave të politikave, përmes kontrollit, prokurimeve dhe mbikëqyrjes për të siguruar përdorim ekonomik, efikas dhe efektiv të burimeve publike.</i>	- Rritja e qëndrueshmërisë së parashikueshmërisë së tavanëve buxhetore afatmesme, nëpërmjet përcaktimit të treguesit “devijime të tavanëve të Programit Buxhetor Afatmesëm/ nga tavanit buxhetor i miratuar nga Parlamenti”, që do të përfshihet në Strategjinë e re të Menaxhimit të Financave Publike – aktivitet në vazhdim. - Legjislacioni dytësor/udhëzim i përgatitur për të detajuar procedurat për përgatitjen e një aneksi specifik që përbëhet nga përllogaritjet e devijimeve dhe arsyet përkatëse, deri në fund të vitit 2025. - Ligji i ri “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme” dhe aktet nënligjore përkatëse të përgatitura dhe të miratuara me qëllim përmirësimin e të ardhurave nga kjo taksë – deri në fund të vitit 2024. - Përafrimi i legjislacionit tatimor shqiptar me direktivat e BE-së në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE - në vazhdim.	- Rritja e ndërgjegjësimit dhe llogaridhënies së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Këshillit të Ministrave në procesin e përgatitjes së tavanëve buxhetore në të gjitha fazat – në vazhdim. - Zbatimi i legjislacionit dytësor/ udhëzim për të detajuar procedurat për përgatitjen e një aneksi specifik që përfshin përllogaritjet e devijimeve dhe arsyetimet përkatëse - viti 2026 e në vazhdim. - Zbatimi i metodologjisë së re për hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe zbatimin e buxhetit në nivel produkti; Prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në Programin Buxhetor Afatmesëm, duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së monitorimit dhe zbatimit të buxhetit vendor – deri në fund të vitit 2026. - Përgatitja e raportit vjetor: "Mbi situatën e vështirësive financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore", për monitorimin e gjendjes financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore - Në vazhdim - Përgatitja e paketës fiskale për përmirësimin dhe thjeshtimin e procedurave zbatuese të legjislacionit tatimor – në vazhdim.	- Ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore planifikojnë politikat e tyre sektoriale bazuar në një tavan më të qëndrueshëm dhe më të besueshëm të vendosur nga MFE-ja dhe Këshilli i Ministrave – viti 2026 e në vazhdim. - Objektivi përfundimtar i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) 2022–2026 është rritja e të ardhurave me +2.5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto – deri në fund të vitit 2026.
	- Monitorimi efektiv i risqeve fiskale, veçanërisht atyre që lidhen me detyrimet kontingjente, është prioritet për menaxhimin e financave publike - në vazhdim - Ngritja e Këshillit Fiskal - fundi i vitit 2026. - Konsolidimi fiskal vazhdon të jetë objektivi kryesor i politikës fiskale për të garantuar	- Një dokument përshkrues i përgatitur që paraqet modalitetet e mundshme për Këshillin Fiskal të përshtatur me kontekstin shqiptar. Identifikimi i mundësisë së duhur - fundi i vitit 2026. - Zhvillimi i planit të kostuar për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Fiskal – fundi i vitit 2026.	- Publikimi i Deklaratës së Risqeve Fiskale si një dokument më vete, çdo vit brenda muajit maj të vitit fiskal të ardhshëm – duke filluar nga viti 2024. - Zbatimi dhe monitorimi i Parimeve dhe Rregullave Fiskale pasqyrohen në raportin vjetor “Raporti i konsoliduar i zbatimit të buxhetit” nga MFE, në mënyrë të detajuar, dhe publikohet në

	stabilitetin makroekonomik të vendit gjatë gjithë kohës dhe veçanërisht gjatë sfidave dhe vështirësive ekonomike, si një premisë thelbësore për të siguruar një rritje ekonomike relativisht të lartë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse - gjatë periudhës afatmesme 2023–2030.	- Përgatitja dhe zbatimi i ndryshimeve të nevojshme në legjislacionin përkatës (duke përfshirë një akt nënligjor) për funksionimin e këshillit fiskal – fundi i vitit 2026. - Krijimi i një bazë rregullative të përhershme dhe të dedikuar për përgatitjen e Deklaratës së Risqeve Fiskale si një dokument më vete. - Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të konsolidojë më tej kapacitetet e Njesisë së Riskut Fiskal përmes asistencës teknike, për konsolidimin përfundimtar të pasqyrës së parë të riskut fiskal, brenda majit 2024. - Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të forcojë kapacitetet e Njesisë së Riskut Fiskal duke marrë në konsideratë asistencën nga partnerët ndërkombëtarë për përmirësimin e monitorimit dhe menaxhimit të riskut fiskal, brenda vitit fiskal 2025. - Investime të vazhdueshme në forcimin e kapaciteteve të njesisë dhe burimet njerëzore, nëpërmjet trajnimeve të rregullta dhe shkëmbimit të njohurive, të paktën një trajnim në vit - çdo vit. - Në planifikimin buxhetor afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj PBB-së do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar i një viti më parë, derisa niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë nën prapun prej 45% të PBB-së – aktivitet në vazhdim parashikuar në ligjin organik të buxhetit (LOB). - Në çdo ligj buxhetor vjetor duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim, balanca primare aktuale nuk mund të jetë negative, duhet të jetë të paktën e balancuar ose pozitive (teprica primare) – viti 2024 e në vazhdim nga LOB-i. - Koordinim i ngushtë i MFE-së me investitorët dhe aktorët e tregut në drejtim të rritjes së transparencës, parashikueshmërisë dhe efektivitetit të procesit të huamarrjes në përputhje me objektivat e strategjisë afatmesme të menaxhimit të borxhit – në vazhdim.	faqen zyrtare të MFE-së - çdo vit. - Praktikë e vendosur për përgatitjen dhe publikimin e planit vjetor të huamarrjes para fillimit të vitit të ri kalendarik - periodikisht çdo vit. - Krijimi i mekanizmit për monitorimin, analizimin, përcaktimin e sfidave dhe përmirësimin e zbatimit më efektiv të strategjisë afatmesme të menaxhimit të borxhit – në vazhdim. - Forcimi i kapaciteteve për vlerësimin e riskut që rrjedh nga garancitë shtetërore të huasë – në vazhdim.
	- Ligji i ri për të zëvendësuar ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat PPP” do të përgatitet dhe miratohet në fund të vitit 2024 dhe do të harmonizohet me	- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndjek me përpikëri vendimin nr. 887 /2022 të Këshillit të Ministrave mbi procedurat e menaxhimit të investimeve publike për përgatitjen	- Ofrimi i trajnimeve për zbatimin e procedurave të reja për menaxhimin e investimeve publike – në vazhdim. - Forcimi/zhvillimi i kapaciteteve të

	kuadrin ligjor të menaxhimit të investimeve publike dhe ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor. - Hartimi dhe miratimi i metodologjisë së përditësura për inventarizimin, vlerësimin dhe zhvlerësimin e aseteve në sektorin publik – deri në mesin e vitit 2025. - Zhvillimi i metodologjisë për vlerësimin e projekteve të reja koncesionare/PPP – deri në fund të vitit 2026	e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe ligjit për buxhetin e vitit – në vazhdim. - Përmirësimi/përshtatja e Sistemit Shqiptar Informatik të Menaxhimit Financiar (AFMIS) për të reflektuar ndryshimet në procedurat e reja të Menaxhimit të Investimeve Publike – deri në fund të vitit 2024. - Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për zhvillimin e një liste unike të projekteve duke përfshirë partneritetin publik privat / koncesionet – deri në vitin 2025. - Plotësimi i bazës së plotë të të dhënave të kontratave të monitoruara dhe ndjekja e procesit të monitorimit të kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat – në vazhdim.	institucioneve qeveritare përmonitorimin e kontratave koncesionare/PPP – në vazhdim. - Krijimi i mekanizmave efikasë në lidhje me monitorimin e kontratave koncesionare/PPP, në mënyrë që risqet e palëve kontraktuese, me fokus të shtuar tek autoritetet kontraktore, të jenë sa më të ulëta për të siguruar përfitimin dhe dobinë më të madhe të këtyre kontratave – deri në fund të vitit 2026. - Konsolidimi dhe përmirësimi i metodologjisë së vlerësimit të projekteve të reja koncesionare/PPP – deri në fund të vitit 2026. - Forcimi i rolit të autoriteteve kontraktore në përcaktimin e procedurave që zgjidhen për kontratat publike, për të vlerësuar se cilat procedura maksimizojnë “vlerën më të mirë për paranë” dhe “vlerën për njerëzit” - deri në fund të vitit 2026.
--	--	---	---